



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 144

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “ALEANCA PËR DEMOKRACI DHE SOLIDARITET”, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1389 Prot., datë 6.3.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, me kryetar z. Gaqo Apostoli

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia politike “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Gaqo Apostoli, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

Data: 8.3. 2023 Nr: 144
Ora: 11:00



Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 6.3.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, me initiale “ADS”, me kryetar z. Gaqo Apostoli rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet” me shkronja nistore “ADS”, me adresë Rruga “Grigor Heba”, pallati 45/2, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Gaqo Apostoli, me adresë Rruga “Grigor Heba”, pallati 45/2, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Olti Cane, me adresë Rruga “Dibrës”, pallati “Andi Konstruksion”, shk. 2, Ap. 1, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Agron Leskoviku, me adresë Rruga “Brigada e 8-të”, pallatet “Agimi” shk. 25, Ap. 397, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia politike “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga partia politike “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64 pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, me kryetar z.Gaqo Apostoli, me shkronjat nistore “ADS”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI